



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:278808

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05309184

KE.nr. 1854/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit Ndërmarrjes Shoqërore nën likuidim NSHG “Rilindja” Shtypshkronja, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me seli në Prishtinë, rr. “Rexhep Mala”, nr. 2, kundër të paditurës Gazeta “Infopress”, me seli në Prishtinë, pallati i mediave, rr. “Garibaldi”, me objekt kontesti lirim dhe pronës dhe kompensimin e qerasë, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, me datën 09.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështje kontestimore me numër KE.nr. 1854/22, sipas padisë së datës 10.07.2015, të ushtruar nga paditësi Ndërmarrjes Shoqërore nën likuidim NSHG “Rilindja” Shtypshkronja, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), kundër të paditurës Gazeta “Infopress”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti lirim dhe kompensimin e qerasë.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj t’i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi Ndërmarrjes Shoqërore NSHG “Rilindja” Shtypshkronja, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me datë 10.07.2015, ka ushtruar padi në

Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të paditurës Gazeta “Infopress” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti Lirimi i pronës dhe pagesa e qerasë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin C.nr. 1619/2015, të datës 18.06.2021, është shpallur jo kompetente ne pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, ndërsa lëndën ia ka dërguar Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë është transferuar për shqyrtim në Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe ka marrë numrin KE.nr. 1854/22, sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të lëndës në kuptim të nenit 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditës në këtë çështje kontestimore është Ndërmarrja Shoqërore nën likuidim NSHG “Rilindja” Shtypshkronja, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ndërsa e paditur Gazeta “Infopress” me seli në Prishtinë.

Sipas nenit 5, paragrafi 7 Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është përcaktuar se: *“Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 të këtij neni...”*. Ndërsa, neni 6 i po të njëjtit ligj përcakton se paditës në procedurën para Dhomës së Posaçme është: *“... 1.3. Agjencia, që pretendon të drejta pronësie apo posedimi apo interesa të tillë mbi apo në: 1.3.1. pasuritë në pronësi apo posedim të një personi fizik apo juridik, apo nën administrimin e autoritetit të saj personal”*. Andaj, meqë palë paditëse në këtë çështje rezulton të jetë ndërmarrja shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, bazuar në dispozitat e cituara si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se kompetente për të vendosur është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Nga sa më sipër, në mbështetje të dispozitave nga neni 17 dhe 19, lidhur me nenin 387.1, pika u) dhe 392, pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1854/22, datë 09.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate